



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 82/10

Prishtinë, më 14.05.2010, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Gani Koci, Naser Osmani, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Armend Zemaj, Shkumbin Demaliaj, Xhevdet Neziraj Suzana Novobërdaliu dhe Hajdin Abazi.

Mungoi: Myrvete Pantina, Besa Gaxheri dhe Mufera Sinik.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza zv. Drejtor i MEF-it, Teki Shala dhe Ramadan Islami nga GTZ, monitorues nga Zyra e presidentit, OSBE, NDI, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasha Prica Tisma, Vilson Ukaj dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit, të mbajtura më datë 14.04.2010 dhe 23.04.2010;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009, I ftuar: Z. Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave;**
- 4. Shqyrtimi i Marrëveshjes për Kredi dhe Grant ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) I ftuar: Z. Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente;**

7. Shqyrtimi i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;
8. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të kryqit të kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;
9. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje me raportin e komisionit funksional – Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, me amendamente;
10. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit, të mbajtura më datë 14.04.2010 dhe 23.04.2010;

Naser Osmani theksoi se në procesverbal, kur flet kryetari duhet shkruajtur kryetari dhe jo kryesuesi.

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009

Kryesuesi theksoi se raporti është dorëzuar me kohë dhe i njëjti përmbush dispozitat e nenit 46 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Bedri Hamza plani vjetor buxhetor ka qenë 1,156,500 miliard €, ndërsa plani i të dalurave 1.423.929 miliard €, duke përfshirë të hyrat vetanake të vitit 2008 e të bartura në vitin 2009. Të hyrat vitin 2009 duke mospërfshirë grantet e përcaktuara nga donatorët kanë qenë 1,146,817,000 € miliard dhe paraqesin 99.2% të planit vjetor dhe kemi pasur një rritje prej 22 % krahasuar me vitin 2008. Sa i përket strukturës së të hyrave, në kufij të hyrat mbulojnë 55% e të hyrave totale apo 634.146.000 € (rritje prej 5% krahasuar me vitin 2008), nga ATK 16 % e ty hyrave totale në shumën prej 264,69.000 € (tejkallim prej 3% e planit vjetor), të hyrat komunale prej 4% 48.29.3000€ (rritje 13%) , të hyrat vetanake të nivelit qendror 3% apo 29,65.7000€ (rritje prej 2%), të hyrat jotatimore qeveritare 5 %, 53.62.000€ (tejkallim prej 6%) dhe e hyra e arkëtuar nga dividenda e PTK-së me vendimin e qeverisë prej 200 mili € dhe paraqet 17% e totalit të të hyrave. Sa i përket të dalave, duke mos përfshirë grantet e donatorëve dhe fondet me mirëbesim kanë qenë 1.232.33 miliard, rritje e të dalurave kryesisht te investimet kapitale. Për paga dhe mëditje janë 264.39.600€ apo 21% (95% krahasuar me planin), për mallra dhe shërbime 159,762.000 € 12% (realizim prej 85% e planit vjetor), shërbimet komunale 19.225.000 apo 2% (realizim prej 85% e planit vjetor), subvencionet dhe transferet 25.691.000 21% (realizim prej 98% e planit vjetor), shpenzimet kapitale 438.000.00 € 32 % e të hyrave totale (realizim prej 80% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me vitin 2008 kemi ngritje prej 15% të ekzekutimit të tyre). Nga buxheti janë bërë edhe disa pagesa tjera, si pagesa për anëtarësimin e Kosovës në institucionet ndërkombëtare financiare (BB dhe FMN) një shumë prej 17.30.000 milion €, pagesat në emër të borqit për BB 43,815.000 € (për këtë qëllim nga në formë donacioni nga qeveria amerikane janë paguar 84,118.439€, nga komisioni evropian 5 milion €) në emër të kredisë për KEK-un 78.829.000 €.

Grantet e përcaktuar të donatorëve duke përfshirë edhe ato të vitit 2008 janë 27.955.000€. Pas shpenzimit të një pjese gjendja në fund të vitit 2009 është 856.1000 janë bartur në vitin 2010. Nga kjo shifet se gjenda e fondeve është 349.930,000 € të cilat fonde barten 2010. Në kuadër të këtyre fondeve bëjnë pjesë rezerva buxhetore e planifikuar 200 mili €, fondi për shërbimin e borqit 12 milion € dhe huaja e KEK-ut 21 mili €. Sipas ligjit mjetet nga fondi i privatizimit nuk janë para publike prandaj edhe nuk janë paraqitur në pasqyrat financiare primare.

Armend Zemaj vlerësoi të rëndësishme sikur të kishim informatat shtesë për nivelin e shpenzimeve të nivelit qendror dhe komunal. Te shpenzimet për mallra dhe shërbime megjithë premtimin për kursimin tyre ende nuk po kalohet ky sindromë. Akoma të hyrat më të mëdha mbeten nga doganat edhe pse kemi rritje të hyrave të brendshme si rezultat i ndryshimit të normave fiskale. Pyeti si kanë ndikuar ndryshimi i normave tatimore, në aspektin e ngritjes apo uljes së të hyrave, në kategoritë e caktuara? Vlerësoi të panevojshme dhe të paarsyeshme shpenzimet që bëjnë ministrat dhe kryetarët e kuvendeve me rastin e urimit të festave zyrtare nëpër gazeta. Në shpenzimet kapitale përgëzojë për përmisimin e trendit të tyre. Raporti i plotëson kushtet ligjore dhe përkrahu atë.

Kryesuesi aktivizimi i përfaqësive diplomatike dhe krijimi institucioneve dhe komunave të reja kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve për mallra dhe shërbime. Rritje për urime të festave nuk kanë dikur shumë, është shpenzimi i planifikuar i organizatës buxhetore. Për të parë efektet e ndryshimit të pakos fiskale këtë përgjigje mund ta marrim përmes një raporti të performancës apo një analize më të thuktë nga MEF-i.

Bedri Hamza politikat fiskale kanë qenë të dizajnuara në atë mënyrë që efekti i tyre për buxhetin të jetë neutral, sepse kemi pasur ulje të tatimeve direkte (në të ardhurave dhe korporatave) kompenzimi i humbjeve të buxhetit është bërë nga ngritja e tatimeve indirekte (akciza nga 17-21€ dhe TVSh nga 15-16%). Sa i përket shpenzimeve për mallra dhe shërbime si MEF bëjmë përpjekje që të kemi shpenzime dhe mjetet të orientohen në shpenzime kapitale, por megjithatë është në pavarësinë e agjencioneve buxhetore në menaxhimin e buxhetit të tyre dhe ne kemi paraqitur ashtu si kanë ndodhur ato.

Safete Hadërgjonaj theksoi se raporti përfshinë të gjithë elementet e parapara me LMFP dhe krahasuar me raportet tjera është dukshëm më i mirë, ka të arritura në menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit. Mbështeti qëndrimin që në të ardhmen të kemi një raport të performancës për ndryshimin e politikave fiskale. Nga raporti shifet se kemi një realizim dukshëm të mirë të hyrave në ato që janë planifikuara dhe rritje e tyre krahasuar me vitin e kaluar, sidomos ku merret parasysh edhe ndikimi i krizës financiare. Edhe të të dalurat kemi një përmisim të strukturës së shpenzimit të tyre dhe këto dy vitet e fundit është bërë një përmisim i mënyrës së shpenzimit, shumica e buxhetit po shkon aty ku përfitojnë qytetarët. Edhe përkundër krijimit të institucioneve nga ajo që është planifikuar, ka pasur rënie të shpenzimeve për mallra dhe shërbime në shumë kategori, e njëjta situatë është edhe të pagat dhe mëditjet. Duhet vlerësuar edhe rritjen e të hyrave nga komunat, që vazhdimësi po vijnë duke u rritur, si dhe në shumicën e komunave kemi shpenzime dukshme më të mira në investimet kapitale krahasuar me të kaluarën. Ndërsa shpenzimi i ulët mjeteve kapitale në Ministrinë e Punëve të Jashtme (vetëm 5%), po ndikon negativisht edhe në buxhetin e përgjithshëm. Një tjetër problem ka të bëjë me agjencionet e pavarura, të cilat në fazën e miratimit të buxheti kërkojnë mjete shtesë nga Kuvendi, ndërsa këtu shifet se kanë efikasitet të ulët të shpenzimit të buxhetit të tyre që reflektojnë edhe në shpenzimet totale. Vlerësoi si të shumta faturat e papaguar që janë bartur vitin e ardhshëm. Po ashtu edhe shumta të mëdha për avanset e pambyllura në disa ministre (sidomos ato në Ministrinë e Shëndetësisë 86.000 €, Ministrinë e Punëve të Brendshme 27.000€, Ministrinë e Forcës së Sigurisë 22.000 €).

Naser Osmani në raportin e prezantuar ku paraqiten të hyrat dhe të dalurat, kemi të hyra 1.168 miliard dhe të dalura 1.252 miliard, një dallim 83 milion €, ndërsa paratë e gatshme në fillim të vitit janë 475 miliard euro, ndërsa në fund të vitin janë 383 miliard euro, që shifet një dallim prej 91 milion euro. Pyeti si është mbuluar ky dallim i të hyrave dhe të dalurave, prej cilave mjete? Më pas pyeti PTK-ja në vitin 2009, ka deklaruar dividend 200 milion euro dhe Qeveria si pronare në bazë të një vendimi ka futur në buxhet, ndërsa dje Qeveria me një vendim kërkon që PTK-ja ti paguaj 80 milion euro, një sqarim për këtë? Pse ky deklarimit të dividendes është bërë në shuma absolute, kur këtë çështje e përcakton ligji.

Xhevdet Neziraj vlerësoi të rëndësishme të kemi në mënyrë detale një tabelë të investimeve kapitale dhe shpenzimin e tyre në agjencionet buxhetore, për të vlerësuar a janë realizuar projektet e parapara dhe si janë bërë ato Problem në mosmbylljen e avanceve, duhet përmisim në këtë drejtim. Është mirë të kemi të hyra më të mëdha nga ato të brendshme, por megjithatë është për tu vlerësuar inkasimi i të hyrave nga doganat, të cilat do të ishin më të mëdha sikur të mund të menaxhoheshin më mirë kufijtë. Vlerësoi të dobishme të kemi një analizë të politikës fiskale për të parë efektet e saj, psh. rasti i rritjes së TVSH-së do të ishte mirë të shihej se a ka ndodhur për shkak ndryshimi i normës tatimore apo si rezultat i përmisimit të efikasitetit të ATK-së.

Kryesuesi po shqyrtojmë pasqyrat financiare të paaudituar, kur të vijë raporti për pasqyrat financiare të audituar mund të shihet se si janë realizuar shpenzimet e planifikuara. Kur kemi shqyrtuar raportet e agjencioneve të pavarura që krijojnë të hyra kemi parë se kemi parë së shumë kompani kanë borqe, psh. KPMM-së afro 10 milion € i kanë borq apo edhe borqet nga ATK-së, do të ishte mirë në të ardhmen të kemi informacione në buxhet që të kërkojnë këto borqe, përmes rrugëve ligjore.

Bedri Hamza sa i përket pyetjes së z. Osmani të hyrat kanë qenë 1,169.7.000 miliard euro, ndërsa të dalurat 1,252.348.000 milion euro, bartja e fondeve nga viti i kaluar ka qenë 475.505€, që na jep gjendjen prej 383.853.00 milion €. Deficiti prej 91 mili € është mbuluar nga bartja e mjeteve e vitit 2008 në vitin 2009. Sa i përket dividendes Qeveria, e më pas Kuvendi kanë aprovuar dividenden prej 200 milion euro për afarizmin e vitit 2008 dhe ka qenë pjesë e buxhetit 2009 dhe dje qeveria ka marrë një vendim për marrjen e dividendes shtesë prej PTK-së prej 80 milion € për vitin 2010 dhe në total për dy vite kemi 280 milion € dividend të deklaruar. Deklarimi i shumave të këtylla është duke mos rrezikuar biznesin e PTK-së në këto dy vite. Çështja e avanceve ne insistojmë që të mbyllet me kohë. Për shkak të fazës së tyre fillestare dhe vështërsive Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Forcës së Sigurisë kanë shpenzuar investimet kapitale në masë më të vogël që ka ndikuar në totalin e shpenzimeve. Bartja e obligimeve këtë vit, një pjesë si rezultat i neglizhencës por edhe për shkak të faturave të shërbimeve komunale që vijnë në janar. Sa i përket kërkesës për shënime shtesë për investimet kapitale, ne kemi përgatitur raportin konform ligjit dhe standardeve të kontabiliteti dhe për çështje tjera mund të bëhet kërkesë e veçantë si komision.

Naser Osmani cilat janë parashikimet në rritjen e të hyrave nga aplikimi i arkave fiskale?

Bedri Hamza aplikimi i arkave fiskale është një prej veprimeve në luftimin e ekonomisë së informalitetit dhe rritjes së buxhetit. Ka me pasur efekt në hyrat buxhetore, por mbi të gjitha është synimi të krijohet një ambient i përshtatshëm për zhvillimin e biznesit dhe një konkurrencë lojale. Ekzistojnë borqe të mëdha ndaj institucioneve të pavarura, ndërmarrjeve publike, ATK-së ne presim që institucionet përgjegjëse të ndërmarrin hapa konkret në inkasimi e këtyre borqeve.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kuvendit që në seancën plenare, të miratojë Raportin financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009.

4. Shqyrtimi i Marrëveshjes për Kredi dhe Grant ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA)

Kryesuesi materiale jo i kompletuar, duke menduar se është çështje urgjente e kemi radhitur për shqyrtim.

Bedri Hamza kemi të bëjmë me dy marrëveshje, njëra me performancën e financave publike tjera me kadastrat e Kosovës. Në mungesë të dërgimit të materialit të kompletuar, sugjeroi që kjo pikë të shtyhet në mbledhjen e radhës, ku do të kompletohet materiali dhe do të diskutohet në praninë e përfaqësuesve tonë.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

- I. Në mungesë të materialit të plotë, shqyrtimi i Marrëveshjes për Kredi dhe Grant ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), shtyhet në mbledhjen e radhës së komisionit.
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Ekonomi,Tregti,Industri,Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente**

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Projektligjin për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara dhe amendamentet e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi,Tregti,Industri,Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion nuk përmbajnë implikime buxhetore, i rekomandohet Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente**

Kryesuesi theksoi se projektligji përmban implikime buxhetore shtesë, por për shkak të rëndësisë së ekzistimit të këtij ligji, propozoi që të rekomandohet që Kuvendi të kërkojë nga Qeveria që të siguroj mjete shtesë për implementimin e tij.

Pas propozimit, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë dhe raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme e Siguri dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.
- II. I rekomandohet Kuvendit, që të kërkojë nga Qeveria të sigurojë mjetet buxhetore shtesë për implementimin e këtij ligji.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente

Kryesuesi në diskutimin dhe miratimin në parim të këtij projektligji ka pasur kërkesa që projektligji përveç kryqit të kuq ligji të rregullojë edhe gjysmëhënën e kuqe, prandaj titulli duhet përmbaj të dy pjesët. Komisioni për komunitete e ka përkrahur këtë kërkesë, prandaj propozoi që edhe ne të rekomandojmë se përkrahim propozimin e këtij, që njëkohësisht është edhe përkrahje e amendamentit të deputetit Riza Smaka.

Naser Osmani nga raporti shifet se komisioni funksional nuk e ka përkrahur atë propozim, ne nuk mund të ndërhyjmë në kompetencën e këtij komisioni, prandaj propozoi që kjo çështje të kalohet për tu zgjidhur në grupe parlamentare. Megjithatë theksoi se nuk mund të krijohen dy organe paralele dhe në këtë formë nuk mund të regjistrohen në mekanizmat ndërkombëtar.

Suzana Novobërdaliu theksoi se pajtohet me konstatimet e kryetarit të komisionit që titulli të përfshijë të dy çështjet dhe për këtë të jepet arsyetimi me shkrim dhe me gojë në Kuvend.

Xhevdet Neziraj janë tri propozime lidhur me titullin e projektligjit, Komisioni për Komunitete ka bërë kompromis dhe ka përkrahur propozimin e Riza Smakës.

Shkumbin Demaliaj më herët kjo çështje ka qenë e rregulluar me rregullore, tani pasi po bëjmë ligjin mund të ndryshohet kjo. Propozoi që ky Komisioni të mbështet propozimin e Komisionit për Komunitete lidhur me titullin e këtij projektligji.

Hajdin Abazi mbështeti propozimin e Riza Smakës.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës me raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe ka konstatuar se dispozitat e projektligjit dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. I rekomandohet Kuvendit që të përkrah propozim-amendamentin e Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim lidhur me titullin e këtij projektligji.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të kryqit të kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Shëndetësi , Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente

Kryesuesi edhe këtu kemi të bëjmë me të njëjtin rast, të rekomandojmë që mbështesim propozim amendamentin e komisionit për komunitete.

Naser Osmani theksoi se emblema e kryqit të kuq është e mbrojtur dhe nuk mundet që të dyja emblemat të ekzistojnë në një vend, nuk pranohet ndërkombëtarisht.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të kryqit të kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve me raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Social dhe ka konstatuar se dispozitat e projektligjit dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- II. I rekomandohet Kuvendit që të përkrah propozim-amendamentin e Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim lidhur me titullin e këtij projektligji.

9. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje me raportin e komisionit funksional – Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, me amendamente

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe amendamentet e komisionit funksional – Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione nuk përmbajnë implikime buxhetore, i rekomandohet Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Gani Koci
